



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCEVE CIVILE

Nr. 1751 / Prot.

Patos më, 05 / 06 / 2025

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. 26 , datë 05 . 06 . 2025

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË PLANIFIKUAR NË
PROGRAMIN E EMERGJENCEVE CIVILE NGA OBJEKTI “BLERJE PAJISJE
KORRËSË AUTOMATIKE PËR NDËRHJRJE NË RASTE EMERGJENTE” NË
OBJEKTIN “NDËRTIM TË MUREVE MBAJTËS PËRGJATË RRUGËS
“YMERAJ”, GJYNAQARË ME QËLLIM PARANDALIMIN E RRËSHQITJES SË
RRUGËS” (BLERJE BAZË MATERIALE)**

Në mbështetje të nenit 54, pika “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”, V.K.B nr. 87, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2025”, Ekipi i programit të menaxhimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit dhe mbrojtjes civile,

KËRKON:

1. Të miratohet përdorimi i fondit të planifikuar nga objekti “Blerje pajisje korrëse automatike për ndërhyrje në raste emergjente” në objektin “Ndërtim të mureve mbajtës përgjatë rrugës “Ymeraj”, Gjytnaqarë me qëllim parandalimin e rrëshqitjes së rrugës” (Blerje bazë materiale).
2. Vlera e fondit që do të përdoret brenda programit është 2,422,374 lekë.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

Të Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimit dhe Mbrojtjes Civile

Drejtues të Programit

Ermenita **MICI**

Alket **HALIMI**

ANËTARËT

Arben **SHPËRDHEJA**

Arlind **RUSTO**

Florian **TORO**

JURISTE

Nurkë **HAZIZAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E PATOS

Nr. 1751/Prot.

2

Patos më, 05/06/2025

RELACION PËR PROJEKT-VENDIM

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË PLANIFIKUAR NË
PROGRAMIN E EMERGJENCAVE CIVILE NGA OBJEKTI “BLERJE
PAJISJE KORRËSË AUTOMATIKE PËR NDËRHJRJE NË RASTE
EMERGJENTE” NË OBJEKTIN “NDËRTIM TË MUREVE MBAJTËS
PËRGJATË RRUGËS “YMERAJ”, GJYNAQARË ME QËLLIM
PARANDALIMIN E RRËSHQITJES SË RRUGËS” (BLERJE BAZË
MATERIALE)**

Bashkia e Patos në buxhetin e vitit 2025 ka miratuar në programin e emergjencave civile objektin “Blerje pajisje korrëse automatike për ndërhyrje në raste emergjente” e cila do të shërbente për pastrimin e bimësisë përgjatë kanaleve me qëllim shmangien e përmblytjeve të tokave bujqësore. Nga ana tjetër nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka miratuar financimin për blerjen e mjetit traktor dhe frezë për pastrimin e kanaleve kulluese në territorin e bashkisë Patos. Këto dy mjete kanë përdorime të ngjashme dhe mjeti i cili do të financohet nga AKMC është më i specializuar dhe përmbush funksionet e parashikuara.

Ekipi i menaxhimit të mbrojtjes civile duke parë situatën ku aktualisht ka filluar zbatimin e marrëveshjes kuadër për shtrimin e rrugëve me asfaltobeton, ku po punohet për hapjen e gjurmës së rrugës “Ymeraj” dhe problematikave të shfaqura si pasojë e terrenit me disnivele të theksuar, ka vlersuar ndërhyrjen me ndërtimin e mureve mbajtëse në disa seksione të rrugës me qëllim vazhdimin e ecurisë së punimeve për shtrimin e rrugës dhe parandalimin e rrëshqitjes së saj. Rruga ka një shtrirje rreth 1 km dhe përgjatë saj në të dyja anët verëhen masive dheu të cilat çënojnë qëndrueshmërinë e rrugës nëse nuk ndërhyhet me ndërtimin e mureve betonarme, me qëllim që të vazhdohet me plotësimin e rrugës me shtresat e nevojshme.

Ky projekt synon të sigurojë banorëve të zonës shërbimet e munguara prej vitesh dhe lehtësimin e qarkullimit.

Fondi me vlerë 2,422,374 (dy milion e katërqind e njëzetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër) lekë do të përdoret ndërtimin e mureve mbajtës përgjatë rrugës “Ymeraj”.

Nisur nga sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratohet përdorimi i fondit të planifikuar nga objekti “Blerje pajisje korrëse automatike për ndërhyrje në raste emergjente” në objektin “Ndërtim të mureve mbajtës përgjatë rrugës “Ymeraj”, Gjyfaqarë me qëllim parandalimin e rrëshqitjes së rrugës” (Blerje bazë materiale).
2. Vlera e fondit që do të përdoret brenda programit është 2,422,374 lekë.
3. Për ndjekjen e zbatimit e projekt vendimit ngarkohet Drejtoria e Projekteve dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Monitorimit të Shërbimeve.

Bashkëlidhur gjendet dhe preventivi i punimeve.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

Të Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimit dhe Mbrojtjes Civile

Drejtues të Programit

Ermenita **MICI**

Alket **HALIMI**

ANËTARËT

Arben **SHPËRDHEJA**

Arlind **RUSTO**

Florian **TORO**

KRYETARI

Fation Duro





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE



MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

BAZE MATERIALE

Objekti : Blerje baze materiale per ndertimin e mureve pergjate rruges "Ymeraj"

Nr.	Analize	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	1.29/p	Beton C16/20 (me cakell)	m3	156.4	8,210	1,283,669
2	2.166	Hekur betoni periodik Ø 10 mm	kg	6800	85	578,000
3	3.183/a	Zhavorr per nenshtrese	m3	28	1,417	39,676
4	treg	Binare (6x12)cm	m3	1	35,000	35,000
5	treg	Betoforma (60x300)cm	m2	23	3,500	80,500
6	1	Gozhde	kg	20	90	1,800
SHUMA						2,018,645
TVSH						2,422,374
SHUMA ME TVSH						2,422,374

Hartoi:

Ing. Ermenita Mici